



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 19 nëntor 2020, në mbledhjen e XXXI-të (tridhjetë e një) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti; Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari, ndërsa mungoi Vendenis Lahu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DSHPMSH dhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera theksoi, konsideroj se thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, kështu që mund fillojmë me punë në këtë takim, urdhëroni nëse dikush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

Njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar për këtë mbledhje

1. Propozim vendimi për rialokimin e buxhetit të Komunës për vitin 2020

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, realisht më takon mua ta arsyetoj këtë propozim vendim pasi që po ndërldhet me buxhet dhe shifra, mirëpo rialokimi është kërkuar nga Drejtoritë të cilat janë të përshkruara në dokument, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit - DPUMM, Drejtoria e Arsimit-DKA dhe nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

DPUMM ka propozuar si projekte të cilat hiqen na buxheti përkatës, kontratat janë në 7 lote dhe mjetet të cilat kanë tepruar nga buxheti i tyre sipas atyre loteve ka propozuar që të shkojnë në projektet të cilat kanë kontratë edhe vitin e ardhshëm por që për këtë vit dinamika është më e madhe dhe është menduar që t'iu ndihmohet në këtë vit të arrihet dinamika edhe me mjete financiare, kjo ka qenë edhe analiza e

kësaj Drejtorie e cila ka kërkuar dhe propozuar që këto mjete të riallokohen, përkatësisht të hiqen nga projektet të cilat kanë tepricë dhe të shkojnë tek projektet të cilat kanë mungesë të mjeteve.

Drejtoria e Arsimit ka një pjesë të vogël të mjeteve tepricë, përkatësisht te projekti i shkollës në fshatin Metehi dhe ka propozuar që këto mjete të riallokohen te projekti i shkollës në fshatin Balloc e cila është në ndërtim e sipër, kontratë e cila përfundon vitin e ardhshëm.

Edhe DSHMS ka mjete tepricë në disa projekte të cilat përfundojnë këtë vit e që sipas kontratave kanë tepëruar mjete financiare nga planifikimi për projektet përkatëse prandaj si drejtori ka menduar të riallokojë ato mjete tepricë, në projekte për pajisje mjekësore, e që besoj se të gjitha janë të arsyeshme, në mënyrë që ato mjete të mbeten të shpenzuara apo suficid në këtë vit apo vitin e ardhshëm.

Pra kjo ishte në pika të shkurtra sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, por nëse në ndërkohë ndokush kërkon sqarime shtesë besoj që do ta sqarojmë më në detaje.

Kryesuesi i Komitetit, ftoj të pranishmit për të marrë fjalën, por meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën e hedh në votim.

Njëzëri nga anëtarët e KPF-së i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës.

2. Propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, gjithashtu e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, sipas Ligjit të ri mbi tatimin në pronë, Komunitat janë liruar prej vlerësimit të pronave të paluajtshme që ka qenë për m² por që tani vlerësimet për të gjitha pronat i bënë Ministria e Financave përmes organizatave të licencuara, gjë për të cilën sigurisht që jeni në dijeni që para një viti kanë mbetur vetëm objektet rezidenciale dhe komerciale të pa vlerësuar prej komisionit dhe na është dashur që me Rregulloren t'ua përcaktojmë vlerën atyre pronave, ndërsa në këtë vit edhe kjo pjesë është kryer prej Ministrisë së Financave dhe komunave u mbetet vetëm të caktojnë norma tatimore për vlerat të cilat ka për t'i marr objektet, parcelat, pyjet e të tjera, kështu që është ardhur deri tek ajo që të implemtojmë ligjin në tërësi dhe Kuvendi Komunal ka obligim vetëm caktimin e normave tatimore për pronat të cilat janë të përshkruara në vendim.

Bazuar në gjendjen ekonomiko-sociale, bazuar edhe në pasojat e pandemisë që mendohet se do të ketë pasoja edhe në vitin e ardhshëm, nuk kemi propozuar asnjë ndryshim për norma tatimore por janë ato që për momentin janë në fuqi sipas Rregullores përkatëse, pra të gjitha normat tatimore janë propozuar në minimumin e asaj që lejohet me ligj, por mbetet kompetencë e Kuvendit të Komunës respektivisht e këtij Komitete meqë jemi në mbledhje të KPF-së që nëse e shoh të arsyeshme që ndonjë normë tatimore prej këtyre që janë propozuar të lëvizë varësisht aq sa e lejon ligji mund edhe të votohet, mirëpo sërish po theksoj se në bazë të analizave që janë bërë edhe viti i ardhshëm do të jetë një vit sfidues dhe që do të përcillet me pasoja (duke shpresuar që nuk do të zgjasë shumë kjo pandemi) të barten për vitin tjetër, kështu që do të punojmë që qytetaret të mos të ngarkohen me tatime shtesë por do të jenë tatime të cilat janë edhe këtë vit me përjashtim që mund të ndodh ndryshime tek vlerësimi për m² në bazë të asaj që ka bërë Ministria e Financave dhe ka bërë zona më tepër se që kanë qenë, pra kemi pasur 4 zona kurse tani na janë caktuar rreth 16-17 zona dhe varësisht prej zonës është përcaktuar edhe vlera për m², kështu që ndoshta ndokund do të ketë ngritje të lehtë ose zbritje për m², por si norma tatimore është shumë me rëndësi të jenë për të gjitha pronat në nivel komunal.

z.Mehmet Gashi, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës është mjaftë e rëndësishme për qytetarët e Komunës së Podujevës. Po ashtu është gjë e mirë nga Komuna e Podujevës që ka propozuar normën më të ulët që është në bazë të ligjit përkatës duke marrë për bazë gjendjen ekonomike të qytetarëve sidomos këtë vit për shkak të pandemisë Covid-19, ne si KPF është mirë ta përkrahim dhe t’ia rekomandojmë Kuvendit që norma të jetë më e ulët e mundeshme në bazë të asaj që ligji e përcakton, e që besoj se 0-15% është norma më e ulët dhe detyra jonë është të përkrahim normën më të ulët dhe për këtë desha vetëm që edhe ne si komitet të kemi një mbështetje dhe t’i propozojmë Kuvendit për miratim.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne si Grup i këshilltarëve nga LVV kërkojmë një material shtesë rreth renditjes së këtyre tatimeve me pronat për shkak se shpjegimi është i ceket.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim këtë propozim vendim sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Njëzëri nga anëtarët e KPF-së i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës.

3. Ngritja e Grupit punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, paraqiti fjalë hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, përkatësisht këtij propozimi për ngritjen e Grupit Punues për përgatitjen e draft - Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021, ndër të tjera theksoi, pasi që është ofruar edhe fundi i vitit është e domosdoshme që të ngritet ky Grup punues për përpilimin e planit të punës për vitin 2021, nëse jemi të përgatitur të vazhdojmë me emrat që propozohen nga ana juaj për ngritjen e këtij Grupi punues.

z.Mehmet Gashi, theksoi, është mirë që është në rend dite propozimi për ngritjen e Grupit punues për përgatitjen e planit të punës së Kuvendit për vitin e ardhshëm, është mirë që të miratohet edhe në këtë vit plani i punës për vitin e ardhshëm dhe atë sipas mundësive në fillim të dhjetorit.

Ne e kemi një model të cilin e kemi përgatitë mirëpo ka mundësi që temat që janë më të rëndësishme t’i parashohim për vitin e ardhshëm dhe mendoj që në krye të këtij Grupi është mirë të jetë Kryesuesi i Kuvendit z.Fatmir Gashi dhe pastaj nga një përfaqësues i Grupeve të këshilltarëve të LDK-së, PDK-së, AAK-së, VV-së, andaj sa i përket propozimeve të anëtarëve në këtë Grup punues, unë edhe pse nuk jam konsultuar për këtë, mendoj se është mirë t’i propozojmë këtu dhe t’ia lehtësojmë punën pastaj Kuvendit, prandaj në emër të Grupit të LDK-së propozoj znj.Fatlume Jaha që të jetë anëtare e këtij Grupit punues.

znj.Adelina Stublla, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LVV-ës propozon z.Fitim Muçollin për anëtar në Grupin punues përkatës.

z.Rafet Llapashtica, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të PDK-ës propozon z.Fatmir Rudarin.

z.Patriot Rudari, theksoi, meqë znj.Mrika Thaqi është e zënë me punë dhe aktivitete tjera, unë e propozoj vetveten për anëtar në Grupin përkatës punues.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, do të thotë që nga subjekti i AAK-së, z.Patriot Rudari është përfaqësues i këtij grupi dhe e arsyeton këtë. Po ashtu i’u informoj që do të ishte mirë që në këtë komision të përfshihet edhe dikush nga Ekzekutivi i Komunës për arsye që të jenë në dijeni sa i përket pikave të planifikuara për shqyrtim në Kuvend në vitin 2021 dhe që të sillen materialet përkatëse si dhe që Plani i punës të jetë sa më i kompletuar, i kapshëm dhe i implementueshëm.

Ky është vetëm një rekomandim pasi dihet se këtu vendime nuk marrim por besoj që është më mirë, dhe të përgatisim një plan program të punës vërtetë siç dimë dhe siç na ka hije. Ne po ashtu me program të punës e kemi të paraparë që deri në muajin dhjetor të miratohet ky plan i punës dhe në seancën e

dhjetorit ky Grup punues që do të ngritët, shpresoj që do të ulët menjëherë dhe do të punoj në mënyrë që në dhjetor të ofrohet për miratim propozim plani i punës së Kuvendit për vitin 2021, e që besoj se do të shfaqim seriozitet dhe në seancën radhës ta kemi të gatshëm.

Nëse ndokush nuk ka të shtoj diçka tjetër, unë e vë në votim se kush është që të rekomandohet Kuvendit kjo pikë e rendit të ditës duke përfshirë edhe emrat e anëtar-ëve të propozuar dhe që për dy anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës të jepen emrat në seancën e Kuvendit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe ngritje të Grupit Punues sipas kësaj pike të rendit të ditës me përbërjen si në vijim, përfshirë edhe propozimet e subjekteve për anëtarë në këtë Grup Punues, dhe atë:

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, kryesues i Grupit punues

znj.Fatlume Jaha, nga radhët e LDK-së, anëtare

z.Fitim Muçolli, nga radhët e LVV-së, anëtar

z.Fatmir Rudari, nga radhët e PDK-së, anëtar

z.Patriot Rudari, nga radhët e AAK-së, anëtar

_____, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, anëtar/e

_____, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, anëtar/e

(Të cilët do të propozohen në mbledhjen e Kuvendit).

Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/01-0070859/20

Podujevë,

19 nëntor 2020

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi